

VENDIM
Nr. 161, datë 7.12.2012

MBI SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE TË KESH SHA, “TEC VLORË” SHA, OST SHA, “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, “ULËZ-SHKOPET” SHA, “BISTRICA 1, 2” SHA PËR PËRDITËSIMIN E TARIFAVE TË GJENERIMIT, TË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË, TË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT, TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE (2012-2014)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërive KESH sh.a., “TEC Vlorë” sh.a., OST sh.a., “CEZ Shpërndarje” sh.a., “Ulëz-Shkopet” sh.a., “Bistrica 1,2” sh.a. për përditësimin e tarifave të gjenerimit, të furnizimit publik me shumicë, të shërbimit të transmetimit, të shërbimit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore (2012-2014), sipas metodologjive përkatëse,

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi tarifat e miratuara nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 7.12.2001 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 87, datë 29.6.2012 “Për rishikimin e tarifës për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80, datë 15.6.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”, vendimin nr. 151, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlorë sh.a. të FPSH, për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 152, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Bistrica 1, 2” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 153, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Lanabregas” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 154, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimin nr. 146, datë 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore”, vendimeve nr. 147, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014”, vendimin nr. 148, datë 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore”, vendimi nr. 149, datë 7.12.2012 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012”, vendimi nr. 150, datë 7.12.2012 “Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012”.

2. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, do të përditësojë vendimet e parashtruara në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 30 qershor 2012.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesit për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani